



Si ligjërojnë liderët politik shqiptarë?  
Turqia akuzon BE – në për paragjykimet  
Ja prioritetet e Presidencës Irlandeze të BE – së

# EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr. 14 Janar 2013

## Speciale

**Politikat e punësimit: Pak efikase dhe të pa-përshtatura me realitetin e tregut. Bashkëpunimi i ngushtë me bizneset, rruga për përmirësimin e tyre**



Kartatura: Fazel Hoxha

Jemi mësuar me faktin që papunësia mbetet një problem shqetësues prej dy dekadash tashmë. Aq shumë na është mësuar veshi, sa që përtej retorikash e premtimesh politike, pak diskutohet për përmbajtjen e politikave të punësimit të zbatuara vitet e fundit në Shqipëri. Pak mund të thuhet për ndikimin, apo mungesën e ndikimit të tyre në

zbutjen e papunësisë, këtij fenomeni që kushtëzon mirëqenien aktuale, çënon të ardhmen e brezave dhe përcakton rrjedhën e shumë fenomeneve sociale. Në një prej studimeve të fundit, EMA vë në fokus pikërisht efikasitetin e programeve aktuale të punësimit dhe mënyrat për përmirësimin e tyre. Shqipëria ndodhet në një fazë vendimtare të reflektimit mbi gjendjen aktuale

...vijon në faqen 2 >>

## Rinia shqiptare: Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen!



Pak kohë më parë, Zyra e Fondacionit Friedrich Ebert në Tiranë, publikoi gjetjet e një studimi, i cili na jep një pasqyrë interesante të qëndrimeve që kanë të rinjtë shqiptarë ndaj çështjeve të tilla si, familja, feja, shoqëria, arsimit, punësimi, koha e lirë apo edhe këndvështrimet e tyre mbi raportet e vendit tonë me vendet e tjera të rajonit dhe BE-në. Studimi i

referohet realitetit të Shqipërisë së sotme që ende ecën drejt një tranzicioni disi të zgjatur. Rinia shqiptare paraqitet deri diku konfuze duke reflektuar njëfarë paqëndrueshmërie ndaj qëndrimit të vlerave sociale, ekonomike, politike dhe atyre të trashëguara.

Kur flitet për besimin tek të tjerët në shoqëri, grupi ku të rinjtë besojnë më shumë janë familjarët e tyre, ndërsa ata që gëzojnë më pak besim janë

...vijon në faqen 6 >>

## Sa ka përfituar Shqipëria deri më tani nga fondet IPA?



*Intervistë me Vassilis Maragos, Shef Njësie, Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit pranë Komisionit Europian*

**EuroSpeak:** Viti 2003 është viti i fundit i programit aktual të IPA - s dhe programi vijues, IPA II, është diskutuar për vitet 2014 - 2020. Si do ta vlerësonit ju efektivitetin e saj në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor tani që ka disa projekte të përfunduara dhe të tjera në proces?

**Vassilis Maragos:** Që nga viti 2007 Shqipëria ka përfituar nga fondet në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA), që arrijnë shumën e përgjithshme prej më shumë se 550 milionë euro. BE-ja është donatori i parë në Shqipëri dhe është e

...vijon në faqen 3 >>

## Politikat e punësimit: Pak efektive dhe të pa-përshtatura me realitetin e tregut. Bashkëpunimi i ngushtë me bizneset, rruga për përmirësimin e tyre

...vijon nga faqja 1 >>

të tregut të punës. Afati kohor për implementimin e Strategjisë Sektoriale të Punësimit 2007 - 2013 është pranë mbarimit, dhe muajt në vijim do të jenë një periudhë kyçe për të vlerësuar situatën dhe për të kryer një rikonfigurim të politikave të punësimit. Ndërkohë, zhvillimi i programit të dytë të Instrumentit të Para-Aderimit IPA 2014 -2020 është drejt përfundimit. Kjo do të thotë se vendi



duhet të synojë të rishikojë politikat e punësimit dhe në të njëjtën kohë të përfundojë përgatitjet për të përfituar nga komponentët e IPA-s. Në mbarim të afatit për zbatimin e Strategjisë së Punësimit, tregu shqiptar i punës paraqet disa karakteristika që vënë në diskutim eficientën e politikave të zbatuara deri më tani.

### Realiteti në tregun e punës

Falë faktit që është një nga vendet e rajonit me moshën më të re të popullsisë dhe ku popullsia në moshë pune (15 – 64 vjeç) përbën rreth 64.3%, Shqipëria disponon një kapital njerëzor sa të vyer, aq dhe të vështirë për tu integruar në tregun e punës. Kjo pasi një pjesë e konsiderueshme e punëkërkuesve të papunë u përkasin pikërisht moshave të reja dhe konkretisht, 15.6% e punëkërkuesve të papunë i përkasin grupmoshës deri në 25 vjeç dhe 22.9% i përkasin asaj 25-34 vjeç. Gjithashtu, sipas vlerësimeve të vetë institucioneve shtetërore, tregu shqiptar i punës shënon informalitet të lartë, rreth 24% në zonat

urbane dhe rreth 5% në zonat rurale.

Ky aspekt vështirëson përcaktimin e saktë të nivelit të papunësisë. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave (INSTAT), gjatë tremujorit të tretë 2012, forca e punës ka qenë 1.064. 291 persona, ndërsa shkalla e papunësisë së regjistruar është 13.32 %. Kjo përqindje i korrespondon një shifre prej 141.816 punëkërkuesish të papunë të regjistruar në zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP). Po të marrim parasysh faktin se këto zyra mbeten pak popullore për qytetarët dhe shtrihen vetëm në zonat urbane të vendit, të dhënat që ato disponojnë mbi personat e papunë janë të kufizuara. Gjithashtu kriza ekonomike që ka goditur vende të ndryshme të BE-së, e në veçanti Greqinë, ka ndikuar në shtimin e papunësisë në vend. Kjo pasi shumë imigrantë janë detyruar të kthehen në kushte vështirësie ekonomike. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB), gjatë vitit 2011, 64% e personave të kthyer që u janë drejtuar sporteleve të migracionit, janë regjistruar si të papunë.

Një aspekt shqetësues mbeten punëkërkuesit afatgjatë, të cilët përbëjnë rreth 62.2% të totalit. Gjithashtu tregu i punës në Shqipëri karakterizohet nga aktiviteti i ulët (61.9% në vitin 2009) dhe shkallë e ulët e punësimit (në 53.4%, po në vitin 2009 në krahasim me mesataren dhe objektivat në vendet e BE-së (rreth 70%, viti 2008).

### Sfidat e hartimit të politikave efektive

Për të zbutur papunësinë, aktualisht janë në zbatim pesë programe për nxitjen e punësimit. Këto programe zbatohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, nëpërmjet zyrave rajonale në bashkëpunim me qendrat e formimit profesional. Programet e nxitjes së punësimit kanë në fokus kryesisht punëkërkues të papunë në vështirësi, gratë nga grupe të veçanta, punëkërkues që kanë mbaruar studimet e larta brenda ose jashtë vendit prej jo më shumë se 24 muajsh, si dhe personat që hyjnë për herë të parë në tregun e punës. Megjithatë ekzistenca e programeve të nxitjes së punësimit në parim përbën një shtysë pozitive për nxitjen e punësimit dhe një praktikë që ka rezultuar frytdhënëse në vendet ish komuniste, sot

anëtare të BE-së, të shumta janë problematikat në përshtatjen e tyre sipas nevojave të tregut shqiptar dhe në zbatim. Ndër to, vlen të përmendet fakti se investimi i qeverive Shqiptare në programet e nxitjes së punësimit mbetet modest. Konkretisht, buxheti i alokuar për programet e nxitjes së punësimit në Shqipëri për vitin 2009 ishte 0.016% i Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), shifër kjo rreth 28 herë me vogël se mesatarja e BE-së, 0.46% (në vitin 2008). Ky buxhet ka pësuar ulje të ndjeshme ndër vite dhe konkretisht për vitin 2012 ai rezultoi 40% më i ulët se në 2010, gjë që ka kufizuar dhe më tej numrin e përfituesve dhe impaktin e këtyre programeve. Ndonjëherë, programet hartohen dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave pas miratimit të buxhetit dhe nuk u përcaktohen fonde, duke penguar kështu zbatueshmërinë e tyre.

Pjesërisht programet janë zhvilluar pa marrë parasysh pozicionin e zyrave të punësimit në vend dhe pa ndërmarrë hapa promovues për to dhe mundësitë që ato ofrojnë për kategori specifike. Për shembull, numri i punëkërkuarve të papunë me arsim të lartë të regjistruar në zyrat e SHKP aktualisht është marginal – vetëm 3,7% për vitin 2011. Prandaj, rëndësia e një programi të veçantë për të sapodiplomuarit do të rritej nëse do të behej sensibilizim për të shtuar popullaritetin e zyrave të SHKP në shërbim të qytetarëve të papunë, mes studentëve por edhe mes bizneseve.

Një aspekt tjetër i cili kufizon eficiencën e programeve të nxitjes së punësimit dhe trajnimeve që ofrohen për punëkërkuarët e papunë ka të bëjë me faktin se jo gjithnjë konsultohen me punëdhënësit dhe u përgjigjen kërkesave të tyre. Një shembull është krijimi i programit të nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta, i cili nuk është konsultuar me organizatat kryesore të përfaqësimit të bizneseve.

Një shqetësim për subjektet private mbetet gjithashtu procedura e pjesëmarrjes në programet e nxitjes së punësimit. Sipas përfaqësuesve të bizneseve, ekzistojnë probleme të transparencës si dhe procedura të gjata burokratike, ndërkohë që incentivat për punëdhënësin janë të pakta. Kjo veçanërisht po të marrim në konsideratë sfondin ku operojnë punëdhënësit në Shqipëri - informalitet

dhe numër i lartë të papunësh të pranishëm në treg.

Në tërësi, gjatë vitit 2011 nëpërmjet zyrave të punësimit janë punësuar 11.556 punëkërkuarë të papunë ose 7.8% e totalit të punëkërkuarve të regjistruar (143,002 të regjistruar). Këto shifra modeste dhe kriza ekonomike në vazhdim sugjerojnë se një vizion i ri për hartimin e politikave të punësimit duhet të ravigëzohet në Shqipëri.

Institucionet shtetërore duhet të dëgjojnë me vëmendje sugjerimet nga kompanitë private, një burim kyç për gjenerimin e punësimit sot dhe në të ardhmen. Fokusi i këtyre politikave duhet të zhvendoset nga punësimi i përkohshëm dhe i paqëndrueshëm i punëkërkuarve në situatë të vështirë, tek krijimi i vendeve të punës të qëndrueshme. Në mënyrë që të arrihet kjo, ministritë e linjës si MPÇSSHB dhe Ministria e Transportit, Energjisë dhe Ekonomisë duhet të punojnë ngushtë me njëra-tjetrën, si dhe me aktorë të tjerë relevantë, kryesisht punëdhënësit dhe institucionet ndërkombëtare që mund të mbështesin.

Një politikë punësimi fokusuar në krijimin e vendeve të punës duhet të vlerësojë me kujdes shpenzimet me të cilat përballet një punëdhënës privat për të hapur një pozicion të ri pune dhe të parashikojnë skema konkurruese për të mbuluar këto shpenzime, duke e angazhuar njëkohësisht punëdhënësin të ofrojë punësim për një periudhë të caktuar (p.sh. 5 vjet). Në këmbim, punëdhënësi mund të paguajë këtë shumë në formën e kontributeve ndaj shtetit për çdo person të punësuar gjatë këtyre viteve, duke gjeneruar fonde për mbështetjen e më shumë punëdhënësve në të ardhmen. Ky model, drejt të cilit po shkojnë dhe vende të tjera, do të ishte më efikas në uljen e papunësisë në Shqipëri. Me zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2013 në horizont duket qartë se rikonfigurimi i politikave të punësimit do të mbetet një detyrë për në shtator. Kushdo që të dalë fitimtar, do të përballet me sfidën madhore të krijimit të një vizioni për politika më eficiente në zbatimin e papunësisë, kësaj plaje në gangrenizim e shoqërisë sonë.

*Stafi i EuroSpeak, janar 2013*

## Sa ka përfituar Shqipëria deri më tani nga fondet IPA?

...vijon nga faqe 1 >>

angazhuar në mënyrë aktive në një serë sektorësh. Fillimisht duhet bërë dallimi mes zarfit vjetor IPA për projektet në fushën e forcimit institucional dhe zhvillimit socio-ekonomik (komponenti I i IPA - Asistenca e Tranzicionit dhe Ngritjes së Institucioneve) dhe fondet për bashkëpunim me vendet fqinje (komponenti II i IPA - Bashkëpunimi Ndërkufitar). Programi kombëtar vjetor i gjashtë (2012)


është miratuar së fundmi nga Komisioni European dhe i shtati (2013) është në rrugë e sipër. Këto programe përqendrohen në gjashtë sektorë prioritarë: i. Drejtësia dhe Punët e Brendshme; ii. Reforma e Administratës Publike; iii. Transporti; iv. Mjedisi; v. Përfshirja Sociale; vi. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural. Në të gjithë këto sektorë, BE-ja po ofron një mbështetje të konsiderueshme për qeverinë dhe për Shqipërinë, duke përfshirë institucionet shtetërore dhe qytetarët

të cilët janë përfituesit përfundimtarë të këtyre projekteve. Projektet e shumta me synim rritjen e kapaciteteve të institucioneve shqiptare kanë rezultuar në shërbime më të mira për qytetarët dhe në procedura më transparente. Projektet e infrastrukturës që BE - ja ka financuar deri tani kanë një ndikim të qartë për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Për shembull, me fondet e IPA-s janë ndërtuar dhe rindërtuar disa rrugë rurale në mënyrë që zonat rurale të lidhen me ato urbane, duke rritur mundësinë për tregtinë dhe lëvizjen e njerëzve brenda vendit dhe në rajon. Për sa i takon Bashkëpunimit Ndërkufitar, BE-ja ka mbështetur disa projekte të vogla të zbatuara nga OJF-të dhe bashkitë, të cilat kanë rritur kontaktet dhe bashkëpunimin me vendet fqinje. Prandaj, në përgjithësi, unë jam padyshim i kënaqur me efektivitetin e fondeve IPA nën perspektivat

aktuale financiare të BE-së (2007-2013). Megjithatë, duhet të kujtojmë se këto projekte kanë të bëjnë me reforma dhe/ose infrastruktura shpeshherë komplekse dhe kërkuese. Në këtë mënyrë, ato mund të kenë një efekt të shumëfishuar në vend dhe tek qytetarët e tij. Prandaj përfituesit duhet të tregojnë vazhdimisht zotërim të plotë e të përfitojnë sa më shumë nga të gjitha këto projekte duke siguruar qëndrueshmërinë e tyre në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

### Fondet IPA për Shqipërinë

Komponenti	07	08	09	10	11	12
■ Ndërt. i Institucioneve	54,3	62,1	70,9	82,7	84,3	85,9
■ Bashkëpun. Ndërkufitar	6,6	8,5	10,2	10,4	10,6	10,9
TOTAL	61,0	70,7	81,2	93,2	95,0	96,9



**EuroSpeak:** Cilat janë mësimet e nxjerra dhe si rezultat, cilat do të jenë përmirësimet në programin IPA II? **Vassilis Maragos:** Periudha e ardhshme e zbatimit të programit IPA (2014-2020) do të ndërtohet mbi përvojën e mëparshme. Megjithatë, në bazë të mësimave të nxjerra do të bëhen disa ndryshime. Përmes një qasjeje më gjithëpërfshirëse sektoriale ne duam të rrisim dhe shumëfishojmë ndikimin e ndihmës së BE-së. Nëse sigurohet një përgatitje e mirë, programimi mund të thjeshtohet me anë të programeve shumëvjeçare; ndër-kohë që diferencimi dhe

fleksibiliteti do të rriten. Instrumenti i ri do të përqendrohet në pesë fusha (i) Procesi i Tranzicionit dhe Ngritja e Kapaciteteve, (ii) Zhvillimi Rajonal, (iii) Punësimi, Politikat Sociale dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore, (iv) Bujqësia dhe Zhvillimi Rural dhe (v) Bashkëpunimi Rajonal e Territorial. Fondet e secilës fushë janë në dispozicion për çdo vend pjesë e procesit të zgjerimit pavarësisht nga statusi i tij, qoftë kandidat apo kandidat potencial. Nën secilën fushë, Komisioni do të punojë me vendin përfitues për të hartuar programet sektoriale vjetore ose shumë-vjeçare. Ndryshimi i vërtetë në krahasim me programin e kaluar, është fokusi në qasjen sektoriale, ndërkohë që më parë veprohej në bazë projektsh specifike. Në bashkëpunim me ministritë (e Transportit, Mjedisit, Drejtësisë, e Brendshme) Komisioni do të skicojë programe që do të përfshijnë një sërë masash të ndërlydhura që

adresojnë të njëjtat prioritete sektoriale afatshkurta/gjata. Qasja e re kërkon pronësi edhe më të fortë nga qeveria shqiptare, e cila pritet të kombinojë ndihmat financiare që vijnë nga fondet IPA me buxhetin kombëtar për çdo sektor, në mënyrë që të rritet ndikimi dhe efektiviteti i ndihmës. Në kuadër të Instrumentit të ri, çdo vend përfitues do të hartojë një strategji shumëvjeçare për periudhën 2014-2020, e cila do të vlerësojë nevojat specifike, kapacitetet dhe angazhimet e vendit për reforma dhe do të zgjedhë sektorët për ndihmë në çdo fushë. Për këtë temë specifike, janë ndërmarrë tashmë diskutime shumë paraprake me qeverinë shqiptare dhe do të vazhdojnë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013.

**EuroSpeak:** Në gjithë këto vite një pjesë e mirë e fondeve të IPA-s i janë përkushtuar fushave që i përkasin sundimit të ligjit dhe institucione të shumta marrin asistencë teknike. Gjithsesi, Progres Raporti i fundit i KE-së për Shqipërinë vë në dukje se ende ka mangësi në disa fusha. A mendoni se mund të arrihet progres nëpërmjet kushtëzimit të fondeve të mëtejshme mbi bazën e rezultateve të arritura?

**Vassilis Maragos:** Fusha e sundimit të ligjit është një nga prioritetet më të rëndësishme në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE. Ky është fokusi kryesor i 12 prioritetëve kyçe të identifikuar në Opinionin e Komisionit, në funksion të hapjes së negociatave të pranimit. Ndërsa vendosja e sundimit të ligjit në qendër të politikës së zgjerimit është një nga sfidat kryesore të identifikuar për të gjitha vendet pjesë e këtij procesi nga Komisioni në Dokumentin e Strategjisë së Zgjerimit 2012-2013. Komisioni European pret që Shqipëria të japë më shumë rezultate në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe të vazhdojë të punojë në vendosjen e një strukture gjyqësori të pavarur, efikas dhe të përgjegjshëm.

Në këtë drejtim, që nga viti i parë i Programit kombëtar IPA (2007) agjencitë dhe institucionet shqiptare të zbatimit të ligjit kanë marrë mbështetje në mënyrë intensive për të ndërtuar dhe për të rritur kapacitetet. Unë do të doja të përmendja dy misione të rëndësishme të asistencës teknike të BE-së, PAMECA, për Policinë e Shtetit shqiptar dhe EURALIUS, për institucionet e gjyqësorit shqiptar, të cilat kanë punuar në kontakt të përditshëm me

homologët relevantë në mënyrë që të kryheshin reforma në këto fusha, duke ndihmuar autoritetet të zbatimit e standardeve përkatëse të BE-së. Aktualisht është planifikuar mbështetja e mëtejshme e PAMECA-s dhe EURALIUS-it. Unë jam i bindur se me këto misione të ardhshme dhe të tjera në vazhdim e sipër, projektet për ndërtimin e kapaciteteve në mënyrë efikase do të ndihmojnë në eliminimin e mangësive ekzistuese. Por asistenca e ofruar nga BE-ja, sado e vlefshme, mund të përdoret kur ka përkushtim të autoriteteve shqiptare që duhet të zbatojnë reformat me ndikim të gjerë dhe të sigurojnë qëndrueshmërinë e tyre. Kushtëzimi është një element thelbësor i procesit të zgjerimit i cili përfshin dhe ndihmën. Një vend mund të përparojë në rrugën e BE-së (duke përfshirë edhe dhënien e statusit të kandidatit, hapjen e negociatave për anëtarësim, etj) vetëm në bazë të rezultateve konkrete të arritura. Gjithashtu, për sa i përket ndihmës financiare IPA, për çdo projekt, Komisioni vendos një sërë parakushtesh që duhet të jenë përmbushur para fillimit të zbatimit.

Gjithsesi, nevojitet punë e mëtejshme në rrjedhën e zbatimit të projekteve apo programeve por dhe pas mbylljes, në funksion të vazhdimit të tyre. Në fushën e sundimit të ligjit, para-kushtet mund t'i referohen hartimit të legjislacionit të pranueshëm nga BE-ja ose krijimit të institucioneve. Nëse para-kushtet nuk plotësohen, projektet mund të shtyhen ose të anulohen. Më duhet të theksoj se ne punojmë shumë së bashku me koordinatorin kombëtar të IPA – s, Ministren e Integritetit European, Znj Majlinda Bregu dhe kolegët e saj, por edhe me përfaqësuesit e institucioneve të tjera përfituese. Në periudhën e ardhshme të programit IPA, ne kemi nevojë të përshpejtojmë më tej përpjekjet tona për të maksimizuar ndikimin e fondeve IPA, të cilat në fund të fundit vijnë nga shtetet anëtare të BE-së dhe kontributi i taksapaguesve. Unë jam i bindur se me më shumë vendosmëri të përbashkët dhe një qasje të orientuar nga rezultatet, ne mund të arrijmë që disa nga mangësitë të cilave ju u referoheni të mund të adresohen më mirë. Kjo është punë e autoriteteve shqiptare, por Komisioni do të vazhdojë të ndihmojë në këtë drejtim.

*Stafi i EuroSpeak, janar 2013*

## Rinia shqiptare: Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen!

...vijon nga faqe 1 >>

fqinjët. Bie në sy fakti se origjina fshatare apo qytetare si dhe prejardhja krahinore janë dyfaktorët kryesorë të diskriminimit që hasin të rinjtë. Edhe pse vlerat e sotme më të rëndësishme për të rinjtë janë dinjiteti vetjak, toleranca dhe korrektesa, ata karakterizohen nga një ndjenjë e theksuar paragjykimi ndaj homoseksualëve. Vetëm 16% e të rinjve janë përfshirë në aktivitete vullnetare. Shumica e të rinjve shqiptarë, rreth 80%, e identifikojnë veten si besimtarë të një feje të caktuar dhe vetëm një e pesta e tyre pohojnë se nuk janë të tillë. Besimi i të rinjve të kryeqytetit ndaj fqinjëve të tyre është pothuajse zero dhe shumica e të rinjve shqiptarë do të ndjeheshin më të gëzuar me një fqinj të huaj nga Europa Perëndimore ose SHBA sesa nga Shqipëria. Një ndër dhjetë të rinj nga shtresat më të pasura të popullsisë diskriminohet pikërisht për shkak të pasurisë.

Kur bëhet fjalë për familjen dhe lidhjet shoqërore, 84% e të rinjve shqiptarë vazhdojnë ta konsiderojnë jetesën me familjen si një element të qëndrueshëm të stabilitetit të tyre emocional dhe ekonomik. Bie në sy fakti se edhe të rinjtë nga shtresat e pasura synojnë të mos shkëputen nga familja, por të jetojnë bashkë me të. Familja vazhdon të ketë ndikim në vendimmarrjen e tyre në vendimet më të rëndësishme, duke përfshirë edhe zgjedhjen e partnerit. Rreth 64.1% e të rinjve pohojnë se babai vazhdon të konsiderohet si një nga personat më me ndikim brenda familjes nga të rinjtë, ku pesha e tij është më e madhe në zonën e Veriut dhe në fshat. Martesa dhe fëmijët mbeten modeli dominues për një jetë të lumtur, ku 81.8 % e të rinjve e përfytyrojnë veten e tyre në të ardhmen të martuar dhe të lidhur në një familje. Përballë përparësive të bashkëjetesës dhe martesës të rinjtë shqiptarë shohin tek kjo e fundit si elementin më kryesor ndarjen e përgjegjësive mes njëri –tjetrit. Ndër karakteristikat parësore të partnerit që do të zgjidhnin për martesë, personaliteti dhe interesat e përbashkëta janë ato që kanë rëndësi më të madhe, por një rol të madh po merr edhe ndikimi i pamjes së jashtme. Pavarësisht lirisë së marrëdhënieve mes tyre dhe çlirimit nga tabutë e seksit, ende

45 % e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar e konsiderojnë virgjërinë si të rëndësishme dhe shumë të rëndësishme përkundrejt 20.3% të atyre që e konsiderojnë atë si më pak të rëndësishme apo 18 % që konsiderojnë atë të parëndësishme në lidhjen martesore. Ajo çfarë vihet re është dallimi mes meshkujve dhe femrave ku meshkujt zënë një përqindje më të madhe.

Duket se të rinjtë kanë prirje të konfliktohen më shumë në shkollë sesa në ambiente të tjera sociale si klubi, disko, apo lagjja ku vërehet se të rinjtë nga shtresat e pasura kanë prirje të konfliktohen më shumë se të rinjtë e shtresave të varfra si pjesë e përforcimit më tej të dallimit të identitetit të tyre. Duke hetuar mbi arsimin, siç pritet, femrat përbëjnë shumicën e të rinjve që ndjekin arsimin e lartë, ku mbizotërimi i numrit të femrave përkundrejt meshkujve rritet me nivelin e shkollimit. Lidhur me rezultatet e arritura në mësim, 48.5% e të rinjve i përkasin nivelit mesatar të notave (shumica e notave 7-8) ku meshkujt kanë rezultate më pak të mira sesa femrat. Vetëm 6.1% e të rinjve nuk besojnë tek fenomeni i blerjes së notës. Perceptimi mbi blerjen e notës është më i fortë në qytetin e Tiranës ku shumica e të rinjve, 67.5 %, besojnë se notat blihen. Shumica e të rinjve shqiptarë do të dëshironin të arsimoheshin jashtë vendit. Afro 54.9 % e të rinjve shqiptarë shprehen në përgjithësi me optimizëm për sa i përket shanseve të punësimit në të ardhmen, ku vihet re se femrat janë më optimiste se meshkujt sikurse edhe të rinjtë nga Tirana, përkundrejt atyre nga qytete të tjera. Rreth 35.2% e të rinjve në nivel kombëtar kanë një punë më kohë të plotë a të pjesshme dhe meshkujt e rinj të punësuar janë më të shumtë sesa femrat. Shumica e të rinjve lakmon punën në administratën publike ku 49.3% e tyre do të zgjidhnin këtë sektor për të punuar, ndërkohë që kjo dëshirë rritet me kalimin e moshës dhe nivelin e studimeve. Të rinjtë besojnë më shumë tek njohjet dhe miqtë se sa faktorë të tjerë që mund t'i ndihmojnë në gjetjen e punës. Shumica e të rinjve shqiptarë nuk synojnë të largohen nga vendbanimi i tyre aktual drejt një qyteti apo fshati tjetër të Shqipërisë, por thuajse 70% e tyre duan të emigrojnë jashtë vendit. Të rinjtë besojnë se vota e tyre nuk ka ndonjë ndikim në mënyrën se si qeverisen institucionet. Vetëm

10.7% e të rinjve besojnë se vota e tyre ka rëndësi të madhe në mënyrën se si drejtohen organet e qeverisjes qendrore në krahasim me 18.7% lidhur me qeverisjen vendore. Të pyetur mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin European, shumica e të rinjve në Shqipëri besojnë se vendi duhet të anëtarësohet në Bashkimin European. Të rinjtë shqiptarë besojnë se efekti kryesor i anëtarësimit në Bashkimin European do të jetë zhvillimi ekonomik dhe politik i vendit. Pjesa më e madhe e të rinjve mendojnë se Shqipëria do të jetë anëtare e BE-së brenda 10 viteve. Në përgjithësi të rinjtë e lidhin integrimin e Shqipërisë me lëvizjen e lirë të individëve, por një pjesë e tyre edhe me lëvizjen e lirë të mallrave, përdorimin e monedhës EURO apo mundësinë e punësimit në një ndër vendet anëtare. Një numër i madh i të rinjve shqiptarë i vlerësojnë si të mjaftueshme apo disi të mjaftueshme përpjekjet e qeverisë Shqiptare për të anëtarësuar vendin në BE.

*Stafi i EuroSpeak, janar 2013*

## Kartolina nga BE-ja

### A mund ta shpëtojë integrimi i mëtejshëm modelin social european?



Në një analizë të fundit, Daniel Gros, Drejtor i Center for European Policy Studies në Bruksel rrëzon pretendimin gjerësisht të përhapur se vetëm një integrim më i thellë mund të shpëtojë modelin social "european" nga sulmi i tregjeve në zhvillim. Sipas tij, globalizimi paraqet një sfidë për vendet anëtare të BE-së, por nuk është e qartë sesi më shumë integrim në nivel european do t'i ndihmojë ato të përballen me të. Gjithashtu, nuk është e qartë se cili model social european duhet të ruhet, pasi mes shteteve anëtarëve ka dallime të mëdha në aspektin e madhësisë së sektorëve publik, fleksibilitetit të tregjeve të punës, dhe në çdo tregues tjetër socio-ekonomik. Kërkesa për barazi dhe një shtet të fortë social janë elementet e vetëm të përbashkët të identifikuar në modelin social "european".

Asnjë nga problemet me të cilat përballen sistemet sociale në Europë - rritja e ngadaltë ekonomike dhe popullsia në plakje - nuk mund të adresohet në nivel european. Madje, modelet e ndryshme sociale europiane kanë qenë mjaft të fuqishme, për shkak të mungesës së një master-plani nga Brukseli për t'iu përgjigjur globalizimit. Çdo vend anëtar ka pasur mënyrën e vet të përshtatjes, duke e ditur se nuk mund t'i kthejë rregullat e lojës në favorin e vet. Çelësi për të siguruar të ardhmen e sistemeve sociale në Europë dhe rrjedhimisht është rritja e shpejtë ekonomike. Pengesat në këtë drejtim janë të njohura dhe kanë ekzistuar për një kohë të gjatë pa u zvogëluar Arsyeja është e thjeshtë: po të kishte pasur një mënyrë politikisht të lehtë për të gjeneruar rritje, ajo do të ishte zbatuar tashmë.

Shumica e politikave kombëtare fajësojnë "Brukselin" për zgjedhjet e tyre të vështira, duke krijuar përshtypjen se ekonomia do të përmirësohet nëse ajo do menaxhohet pa ndërhyrjen e BE – së. Më shumë integrim po predikohet në nivelin european, portretizuar si pengesë për rritjen ekonomike në kontekstin e shteteve anëtare. Por ndërkohë, pretendimi se Europa ka nevojë për më shumë integrim për të ruajtur modelin e vet social tashmë e ka humbur kredibilitetin.

*Project Syndicate, 4 janar 2011*

### Irlanda merr presidencën e BE – së



Në janar 2013, Irlanda mori për herë të 7 kryesinë e Këshillit European, datë e cila përkon edhe me 40 vjetorin e anëtarësimit të saj në BE. Prioritetet e kësaj presidencie u përcaktuan në bazë të axhendës dhe iniciativave aktuale të BE-së. Konkretisht, ajo do të fokusohet tek stabiliteti ekonomik, duke filluar me rinovimin e qeverisjes ekonomike; punësimin e të rinjve; krijimin e legjislacionit dhe masave që nxisin ekonominë dixhitale dhe synojnë forcimin e SME-ve; potencialet e burimeve natyrore, në tokë dhe det; si edhe promovimin e marrëveshjeve tregtare dhe ndjekjen e axhendës së zgjerimit. Ndërkohë, për të kremtuar 20 vjetorin e themelimit të qytetarisë së BE-së në Traktatin e Mاستrihtit, Komisioni European e ka shpallur 2013 – ën "Viti European i Qytetarëve", me qëllim rritjen e



ndërgjegjësimin në lidhje me të drejtat e qytetarëve në përcaktimin e të ardhmes së BE-së. Komisioni argumenton se sa më të informuar të jenë qytetarët për të drejtat e tyre, aq më të qartë do të jenë në vendim-marrjen personale. Çka besohet se do të çojë drejt një jete më të gjallë demokratike në të gjitha nivelet.

*Stafi i EuroSpeak, janar 2013*

## Tre qytetarë të zakonshëm shpallen njerëzit e vitit 2012 në Luksemburg



Dy infermiere dhe një shofer autobusi janë votuar Luksemburgezët e vitit 2012 në një anketë online organizuar nga stacioni televiziv RTL në të cilën morën pjesë 3000 anketues. Këta 3 qytetarë të zakonshëm kanë fituar mbi politikanët, artistët dhe sportistët, pasi ata kishin shpëtuar jetën e njerëzve falë profesionit apo punës së tyre vullnetare. Bëhet fjalë për infermierën që punon në spitalin ambulator të kemioterapisë, kolegen e saj vullnetare me grupin e “mjekëve pa kufij” që vizitojnë zonat me konflikte të armatosura për të ndihmuar të dëmtuarit si dhe shoferin e autobusit që shpëtoi jetën e një fëmije zemra e të cilit kishte pushuar së rrahuri. E përditshmja Le Quotidien shkruan: “Përdoruesit e internetit kanë dëshmuar një respekt të madh për këta 3 qytetarë. Në kontrast me pretendentët e tjerë për këtë titull, ata nuk janë mësuar të jenë në qendër të vëmendjes, dhe të nesërmen e dhënies së titullit janë kthyer sërish në punë. Ata përfaqësojnë janë gratë dhe burrat punëtorë që kurrë nuk kanë kërkuar famë, por që në mënyrën e tyre, punojnë për të përmirësuar jetën e të tjerëve, larg vëmendjes. Ne duhet të frymëzohemi nga shembujt e këtyre tre heronjve të përditshëm”.

*Euro Topics, 1 janar 2013*

## Përfundimet e nxjerra nga samiti i energjisë BE – Rusi

Më 21 dhjetor, presidenti rus Vladimir Putin vizitoi Brukselin për samitin e BE-së mbi tregun e energjisë

dhe krizës në Siri. Bisedimet e Putinit në Bruksel u fokusuan kryesisht mbi energjinë, një çështje e një rëndësie të lartë për mbajtjen e pushtetit në Rusi. Ai u mundua të ushtrojë presion mbi BE-në për të përjashtuar gazin natyror “behemoth Gazprom” nga rregullat që synojnë nxitjen e konkurrencës në tregun e energjisë, por nuk gjeti mbështetjen e pjesëmarrësve. Bisedimet e samitit nuk bënë asnjë përparim në zgjidhjen e polemikave midis BE-së dhe Rosisë për sa i përket gazit natyror.

Në këtë samit, Putin gjithashtu dha sinjalet e para të distancimit të Rosisë nga Siria. Duke pohuar se qëllimi kryesor i Rosisë është shmangia e kaosit, Putin ritheksoi qëndrimin e Rosisë se lufta civile në Siri mund të zgjidhet vetëm përmes bisedimeve midis palëve. Ai këmbënguli se “ne nuk jemi një mbrojtës i lidërshiptit aktual sirian” dhe tha se Moska dëshiron “një regjim demokratik në Siri bazuar në vullnetin të popullit.”

Shtetet europiane janë të ndara midis tyre për sa i përket masave që duhen ndërmarrë në Siri, por të paktën kanë filluar të anojnë drejt mbështetjes diplomatike për kundërshtarët e Assad.

*Stafi i EuroSpeak, dhjetor 2012*

## Shkenca duhet të përfshihet më shumë në politikë



Viti 2012 ishte një vit i mirë për shkencën. Fillimisht u zbulua Boson Higgs, duke konfirmuar modelin standard të fizikës së grimcave. Gjithashtu shkencëtarët bënë zbulimin e madh rreth Pikaia

graciliens, i cili përfaqëson fosilin më të vjetër pesëqind milionë vjeçar, paraardhësi i gjallesave vertebrorë të cilave u përkasim. Pa harruar dhënien e çmimit Nobel në Fizikë për Serge Haroche, profesor në Universitetin e Francës. Shkencëtarët në mbarë botën vazhdojnë të përparojnë njohuritë dhe konsolidojnë modelet e tyre teorike të zhvilluara e testuara me dekada. Ama njohuritë gjithnjë e më saktë të akumuluar mbi ngrohjen globale duhet të ndikojnë në optimizmin tonë për

të ardhmen e afërt të planetit dhe njerëzimit më shumë se borxhet shtetërore dhe deficitet. Për sa kohë që shkencëtarët merren me origjinën e materies, jetën apo specien njerëzore, çdo gjë është në rregull. Por në momentin që ata përzihen e ndërhyjnë në jetën politike për të ardhmen e planetit dhe njerëzimit, duket trazuese. Prandaj është në dorën e vendimmarrësve të gjejnë ekuilibrin e duhur mes përparimit shkencor nga njëra anë dhe kritikave të ekzagjeruara për këtë progres nga ana tjetër. Shkencëtarët duhet të aktivizohen më shumë në debatin politik.

*Les Echos, 7 janar 2013*

## Në spitalet gjermane, mundësi karriere për mjekët nga Europa Juglindore



*Në shumë spitale gjermane mungojnë mjekët dhe personeli mjekësor. Specialistët nga jashtë janë gjithmonë të mirëseardhur. Por jo çdo mjek i huaj lejohet të punojë menjëherë në Gjermani.*

Gjendja në spitalet gjermane është shumë e tensionuar, sepse në fushën e mjekësisë mungojnë si mjekë edhe infermierë, prandaj në këtë sektor personeli i huaj është i mirëpritur. Ekzistojnë disa ente të specializuara për ndërmjetësimin e mjekëve të huaj dhe profesionistëve të tjerë për spitale dhe institucione sociale. Deri më tani, ato kanë ndërmjetësuar mjekë nga disa vende të Evropës Juglindore, p.sh. Rumania, Greqia, Shqipëria dhe Kosova, apo dhe nga Polonia, Rusia, dhe që prej krizës së euros, edhe nga Spanja. Profesionalisht mjekët dhe infermierët që vijnë nga këto vende, janë të përgatitur mirë, por në fund të fundit është e rëndësishme, se sa mirë e zotërojnë ata gjuhën gjermane. Para se mjekët të vijnë në Gjermani për të punuar, ata duhet të kapërcejnë pengesën e gjuhës. Kusht është që ata të kenë të paktën nivelin e gjuhës B1, ideale është B2. Falë ligjit të ri gjerman për njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë shtetit që hyri në fuqi më 1 prill 2012, marrja e lejes për të punuar si mjek në Gjermani, nuk lidhet më me shtetësinë e mjekut. Megjithatë, mjekët nga vendet jashtë BE-së duhet t'i nënshtrohen një testi aftësie.

*Deutsche Welle, 12 janar 2013*

## Në pritje të aderimit

### Si ligjërojnë liderët politik shqiptarë?



Edhe pse karakteristikat e ligjërimit politik formojnë kulturën politike të një populli - ndërgjegjësimin politik, pritshmëritë, parashikimet për strategji politike - pak rëndësi i kushtohet analizimit të tij. Para pak kohësh, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – Fondacioni Soros - ka hedhur një hap domethënës në këtë drejtim, duke kryer një studim që pasqyron mënyrën se si liderët kryesorë të politikës (Kryeministri Sali Berisha dhe Kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama) dhe gazetaret me lexueshmërinë më të lartë (Panorama, Shekulli, Shqip, Mapo dhe Gazeta Shqiptare) kanë formuluar diskursin politik për çështje të rëndësishme në vend gjatë dy periudhave - 3 muaj përpara dhe 3 muaj pas zgjedhjeve të 2009-ës dhe 2011-ës.

Në fokus ishin 5 pyetje: 1. Mbi çfarë bazash e përshkruajnë Sali Berisha dhe Edi Rama njëri-tjetrin dhe sa të ngjashme janë këto përshkrime? 2. Sa përputhet ligjërimi i aktorëve në secilin krah politik me ideologjitë përkatëse politike (e majta dhe e djathta)? 3. Si trajtohen gratë, feja dhe minoritetet në ligjërimin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të shkruar? 4. Si trajtohet integrimi në BE? 5. Si trajtohen institucionet?

Pas analizës së fjalorit të përdorur nga dy kundërshtarët politikë ndaj njeri - tjetrit në lidhje me karakterin, performancën dhe përkatësinë, u arrit në konkluzionin që në ligjërimin e dy liderëve nuk gjendet asnjë fjalë pozitive për njeri - tjetrin (sidomos në periudhën menjëherë para dhe pas zgjedhjeve); kritikën mbi performancën përbëjnë vetëm 50% të ligjërimit, ndërsa pjesa tjetër janë kritika personale.

Në lidhje me përputhjen e ligjërimit të liderëve dhe gazetave me ideologjitë përkatëse në çështjet e institucioneve, ligjit dhe rendit, mjedisit, çështjet social-ekonomike dhe vlerat, përfundimet treguan që ligjërimi i djathtë është më i pranishëm. Megjithatë, duhet vërejtur se studimi nuk hulumton në detaj nëse retorika e djathtë e përdorur nga lideri i opozitës përbën në vetvete qëndrime të djathta apo kritika.

Ligjërimi për dhunën ndaj grave është rritur (më shumë tek Rama se Berisha). Ndërkohë që gazetaret diskutojnë më shumë barazinë se përfaqësimin politik të grave. Pozitiv është fakti se në gjuhën e liderëve dhe gazetave, nuk janë evidentuar fyerje ndaj minoriteteve etnike.

Ligjërimi mbi Europën është i shpeshtë në të gjithë aktorët, ama i diskutuar me terma të përgjithshme. Ai bëhet më specifik vetëm për zhvillimin e zgjedhjeve dhe reformat në drejtësi.

Së fundmi, në ligjërimit mbi institucionet vihet re se të dy palët politike sfidojnë ose kërcënojnë institucionet, apo i quajnë të kërcënuara nga pala kundërshtarë.

*Stafi i EuroSpeak, janar 2013*

## Opozita maqedonase: BE – ja po injoron shkeljet që i bëhen demokracisë



Ministri i Transportit, Mile Janakieski tha se deri në vitin 2017, Maqedonia do të investojë 50 milionë euro, të dhëna nga BE-ja nëpërmjet Instrumentit të Paraderimit IPA, në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore. Prioritet do t'i jepet ndërtimit të linjës hekurudhore drejt Shqipërisë si pjesë e aksit mbarë-europian, Korridorit 8. Maqedonia gjithashtu planifikon t'i përdorë fondet për përfundimin e linjës hekurudhore që të çon drejt Bullgarisë, si dhe për të rindërtuar disa seksione ekzistuese të Korridorit 10, i cili lidh vendin me Serbinë në veri dhe Greqinë në jug.

Ndërsa qeveria maqedonase planifikon shpërndarjen e fondeve europiane, opozita vazhdon të bëjë thirrje për shkelje të demokracisë, deri në akuza drejt BE-së. Partia kryesore opozitare e Maqedonisë ka akuzuar BE-në se po toleron kërcënimet që po i bëhen demokracisë në vend. Shkupi u përfshi nga një valë e gjerë protestash që nisën më 24 dhjetor pas përjashtimit nga parlamenti të deputetëve të opozitës si pasojë e bllokimit nga ana e tyre të seancës për buxhetin e vitit 2013. Opozita e ka quajtur datën 24 dhjetor si një "pezullim të demokracisë" në vend dhe ka deklaruar se do të marrë pjesë në zgjedhjet e marsit vetëm nëse rishikohen listat zgjedhore dhe ruhen standartet e OSBE-së.

*Stafi i EuroSpeak, janar 2013*

## Gjykata serbe, verdikt themelor për të drejtat e personave gei



Poster i një fushate senibilizuese të sindikatave në Kanada

Në Serbi, vend i kritikuar vazhdimisht për shoqërinë gjerësisht homofobe, një gjykatë në Novi Sad ka dhënë për herë parë një verdikt që dënon diskriminimin në vendin e punës në bazë të orientimit seksual. Ajo gjobiti me rreth 1.700 euro një burrë për diskriminim kundër kolegut të tij, diskriminim i cili sipas gjykatës i ka shkaktuar viktimites shkeljen e të drejtave personale, reputacionin dhe nderin.

I gjobituri duhet të paguajë gjithashtu dhe shpenzimet gjyqësore prej rreth 850 eurosh, të përballuara nga një shoqatë lokale për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT që dërgoi çështjen në gjykatë. Padiësi ishte ankuar se kolegu i tij e kishte fyer, kërcënuar dhe abuzuar fizikisht. Ky është vendimi i parë për diskriminim në bazë të orientimit seksual në vendin e punës në Serbi. Ashtu si në Shqipëri, komuniteti gei në Serbi është viktimitë e diskriminimit të gjerë, përfshirë këtu dhe gjuhën e urrejtjes dhe sulmet fizike. Në vitin 2011 dhe 2012, autoritetet serbe anuluan paradën gei të planifikuar pas kërcënimeve të

ekstremistëve të djathtë.

Sipas studimeve më të fundit, vetëm 26% e qytetarëve serbë besojnë se shteti duhet të mbrojë të drejtat e homoseksualëve dhe lezbikeve, ndërsa 62% janë kundër.

*BalkanInsight, 10 janar 2013*

## Turqia akuzon BE-në për paragjykitime



Pak ditë më parë, Turqia e akuzoi Bashkimin Europian për paragjykim ndaj progresit të vendit drejt anëtarësimit dhe e fajësoi për minimin e besueshmërisë së BE-së në sytë e publikut turk. Në fakt, një studim i kohëve të fundit i realizuar nga think tank German Marshall Fund illustroi rënien e entuziazmit për anëtarësim në BE në Turqi.

Turqia ka nisur bisedimet e pranimit në vitin 2005, por procesi ka ndalur për shkak të mosmarrëveshjes mbi Qipron. Ankaraja ka mbyllur vetëm një nga 35 "kapitujt" e politikës që çdo kandidat duhet të përmbushë për tu bashkuar me BE – në e nga këto, 13 kapituj negociatash janë bllokuar nga Franca, Qipro dhe Komisioni Europian.

Gjithsesi, Turqia është shprehur se dëshiron të bashkohet me BE-në para vitit 2023, përvjetori i njëqindtë i themelimit të Republikës së Turqisë.

Ministri i Punëve të BE-së në Turqi Egemen Bagis së fundmi është shprehur publikisht se është i papranueshëm subjektiviteti e njëanshmëria e Raportit të Komisionit, injorimi i reformave "të guximshme" në lidhje me zgjerimin e të drejtave për pakicat fetare dhe kritika e vrullshme ndaj gjyqësorit. Sipas Bagis: "Sot nuk ka asnjë qeveri në Europë që është më reformiste se qeveria turke. Ndërkohë që vendet e BE-së po luftojnë në krizë, Turqia po përjeton periudhën më demokratike, të begatë dhe transparente në historinë e saj."

Ministri shpresonte që Franca në muajt e ardhshëm do të zhbllokonte bisedimet mbi anëtarësimin në BE për të paktën dy kapituj. Hollande ka ndalur befaz miratimin e kandidaturës së Turqisë në BE, duke thënë se duhet të gjykohej në kritere politike dhe ekonomike. Ndërsa ministri i jashtëm gjerman Guido Westerwelle tha që viti i ri ofron një mundësi për të trajtuar çështjet e pazgjidhura me energji të ripërtërira.

*EuroActiv, 2 janar 2013*



## Nuk ka vetëm pesimizëm në ekonomi



Pesimizmi mund të sundojë botën e korporatave në vitin 2013. Por Barometrit i fundit Financial Times Global Business, matës i pritshmërive të drejtuesve për vitin 2013 sugjeron se bizneset mund të gjejnë rrugën e tyre të rimëkëmbjes.

Rreth 22% e të anketuarve presin që kushtet e biznesit të përmirësohen, shifër kjo në rritje krahasuar me 14% e vitit të kaluar.

Besimi i përgjithshëm se ekonomia do të shkojë më mirë – si bilanc midis atyre që mendojnë se ekonomia globale do të përmirësohet kundër atyre që presin që ajo të përkeqësohet – u rrit nga minus 39 në minus 11 pikë për vitin 2013. Drejtuesit në Lindjen e Mesme dhe Afrikë janë optimistë. Një në tre besojnë se gjashtë muajt e ardhshëm do të sjellin përmirësim.

Paqëndrueshmëria e tregut është ende një shqetësim kyç për 63% të të anketuarve. Ndërkohë, një mungesë e fuqisë punëtore të kualifikuar shqetëson gati një të tretën e të gjithë drejtuesve. Shqetësimet mbi zonën e euros vazhdojnë. Në përgjithësi, 29% e drejtuesve presin që Greqia të largohet nga eurozona në vitin e ardhshëm dhe 8% presin daljen e Spanjës.

*The Economist, dhjetor 2012*

## Slovenia dhe Maqedonia – vendet më të mira për të bërë biznes në Ballkan

Revista prestigjioze financiare Forbes në listën e saj vjetore ka vlerësuar Slloveninë dhe Maqedoninë si vendet më të mira në Ballkan për të bërë biznes, ndërkohë që Serbia renditet si më e pafavorshme. Nga 141 vende të analizuar, duke u bazuar në faktorët e performancës së tregut të aksioneve, të drejtat e pronës, taksat, teknologjinë dhe inovacionin në mbarë botën, Sllovenia ndodhet në vendin e 23-të të listës dhe Maqedonia në vendin e 37-të.

Vijojnë Mali i Zi, në vendin e 45-të, Kroacia dy vende më poshtë, Bullgaria merr pozitën e 49-të dhe Rumania në vendin e 60-të. Greqia, në luftë me krizën e saj të borxhit, merr pozicionin e 68-të. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia janë në vendet e 74, 85 dhe 90 respektivisht. Lista nuk përfshin Kosovën. Globalisht, Zelanda e Re kryeson listën, e ndjekur nga Danimarka dhe Hong Kongu. Vendet më pak të favorshme për biznes në planet janë Zimbabve, Venezuela dhe Guinea.

*BalkanInsight, 20 nëntor 2012*

## Kulti i Musolinit vazhdon të ekzistojë...



Foto: Spiegel International

Edhe pse mund të duket e vështirë për tu besuar, çdo vit në Itali disa mijëra italianë varin në muret e tyre kalendarë me foto që shpalosin muaj pas muaji madhësitë e Musolinit si lider dhe "kohët e arta fashizmit". Sipas Der Spiegel International, Predappio, fshati i lindjes së Duçes, dikur një vend i panjohur në Emilia – Romagna, është gjithnjë e më shumë destinacion pelegrinazhi dhe adhurimi për dhjetëra mijëra neo-fashistë, italianë ose dhe të kombësive të tjera. Të gjitha këto tregojnë se fashizmi dhe miti i Musolinit nuk janë venitur, përkundrazi po rikthehen.

*Spiegel International, 8 janar 2013*



**Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)** është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritimit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritimit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritimit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritimit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritimit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, si dhe Programit Europe for Citizens të Komisionit European.



Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në faqen e internetit të Lëvizjes Europiane në Shqipëri. Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org).

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: [blerta.hoxha@em-al.org](mailto:blerta.hoxha@em-al.org)

[twitter.com/EMAlbania](https://twitter.com/EMAlbania)   
[facebook.com/EMinALB](https://facebook.com/EMinALB) 

European Movement-Albania  
 Rr. Brigada VIII, Godina 1/3, Ap.9, Tiranë, Albania,  
 Nr. Tel/Fax: +355 4 2253184, [www.em-al.org](http://www.em-al.org), [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)

